



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

PA1 Nr. 08-7

23.01.2025

Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20, neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe neni 85 paragrafi (1) nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Zazeta Zyrtare e RMV-së“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), në pajtim me nenin 10 paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Teksti i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, Njoftimin për ndërprerjen e nevojës së lejes për radiotransmetim nga Republika e Maqedonisë së Veriut – Universiteti “SHN. KIRILI DHE METODI” në Shkup – Njësia Organizative Transmetuese Jofitimprurëse RADIO STUDENTORE STUDENT FM 92.9, nr.23-1317/2 datë 24.12.2024 (nr. ynë ark.08-5275/1 datë 25.12.2024) Deklaratën, numër UZP 28/2025 datë 09.01.2025 (nr.ynë ark.08-62/2 datë 14.01.2025) nga personi i autorizuar – rektori i Univesitetit “SHN. KIRILI DHE METODI” në Shkup dhe Konkluzionin ark.nr.02-245/4 datë 22.01.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 2-të mbajtur me datë 21.01.2025 miratoi:

Aktvendim

për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve

1. FSHIHET nga regjistri i radiodifuzerëve, Republika e Maqedonisë së Veriut – Universiteti “SHN. KIRILI DHE METODI” në Shkup – Njësia Organizative Transmetuese Jofitimprurëse RADIO UNIVERSITARE STUDENT FM 92.9.
2. Ky Aktvendim botohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” dhe në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.
3. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Republika e Maqedonisë së Veriut – Universiteti “SHN.KIRILI DHE METODI” në Shkup – Njësia Organizative Transmetuese Jofitimprurëse RADIO UNIVERSITARE STUDENT FM 92.9, është zotërues i lejes për transmetim në radio, PA1 nr.08-80 datë 07.09.2023, që transmeton program përmes transmetuesi tokësor, në nivel rajonal në zonën e qytetit të Shkupit, shërbim programor destinuar për studentët, në gjuhën maqedonase.

Drejtuar Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) më 25.12.2024, Republika e Maqedonisë së Veriut – Universiteti “SHN.KIRILI DHE METODI” në Shkup – Njësia Organizative Transmetuese Jofitimprurëse RADIO UNIVERSITARE STUDENT FM. 92.9, dorëzoi Njoftimin nr.23-1317/2 datë 24.12.2024 (nr.ynë ark.08-5275/1 datë 25.12.2024) se për shkaqe financiare do të ndërpresë me punë më 31.12.2024. Me rastin e Njoftimit të cituar, Agjencia më 03.01.2025, me Shkresë nr.ynë ark.08-62/1, ka njoftuar transmetuesin në fjalë se në pajtim me nenin 85 paragrafi (1) nënparagrafi 2 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) është e nevojshme të dorëzojë deklaratë të noterizuar nga personi i autorizuar – rektori të Universitetit „Shn. Kirili dhe Metodi” në Shkup, në të cilën detyrimisht duhet cekur se Republika e Maqedonisë së Veriut – Universiteti “SHN. KIRILI DHE METODI” në Shkup – Njësia Organizative Transmetuese Jofitimprurëse RADIO UNIVERSITARE STUDENT FM.92.9, ndërprente me transmetim të programit në radio, duke paraqitur datën e saktë të ndërprerjes me transmetim të programit në radio.

Me datë 14.01.2025 drejtuar Agjencisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut – Universiteti “SHN. KIRILI DHE METODI” në Shkup – Njësia Organizative Transmetuese Jofitimprurëse RADIO UNIVERSITARE STUDENT FM. 92.9, është dorëzuar Deklaratë me numër UZP 28/2025 datë 09.01.2025 e noterizuar (nr.ynë ark.08-62/2 datë 14.01.2025), nga personi i autorizuar - rektori – dr.

Biljana Angelova, se Republika e Maqedonisë së Veriut – Universiteti “SHN. KIRILI DHE METODI” në Shkup – Njësia Organizative Transmetuese Jofitimprurëse RADIO UNIVERSITARE STUDENT FM 92.9 nga data 31.12.2024, ndërpreu me transmetim të programit në radio.

Në pajtim me nenin 85 paragrafi (1) nënparagrafi 2 të LSHMAAV, leja për transmetim në radio ndalon së vlefshmi sipas fuqisë ligjore me deklaratë me shkrim të zotëruesit me të cilin e njofton Agjencinë se ndërpreu me transmetim të programit në radio. Për ndalimin e vlefshmërisë së lejes për transmetim televiziv ose radio sipas fuqisë ligjore Këshilli nuk merr vendim. Agjencia do të fshijë transmetuesin nga regjistri i radiodifuzerëve nëse leja ndalon së vlefshmi sipas fuqisë ligjore (neni 85 paragrafi 2 të LSHMAAV).

Rrjedhimisht nga sa më sipër, dhe duke pasur parasysh nenin 85 paragrafi (1) nënparagrafi 2 dhe nenin 2 të LSHMAAV, me dorëzimin e deklaratës me shkrim të lartpërmendur nga personi i autorizuar – rektorit të Universitetit “SHN. KIRILI DHE METODI” në Shkup, janë përmbushur (plotësuar) kushtet ligjore për ndalimin e vlefshmërisë së lejes sipas fuqisë ligjore, sipas së cilës Agjencia do të fshijë transmetuesin, Republika e Maqedonisë së Veriut – Universiteti “SHN. KIRILI DHE METODI” në Shkup – Njësia Organizative Transmetuese Jofitimprurëse RADIO UNIVERSITARE STUDENT FM. 92.9 nga regjistri i radiodifuzerëve.

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20, neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe neni 85 paragrafi (1) nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të LSHMAAV, në pajtim me nenin 10 paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, Njoftimin për ndërprerjen e nevojës së lejes për radiotransmetim të Republikës së Maqedonisë së Veriut – Universiteti “SHN. KIRILI DHE METODI” në Shkup – Njësia Organizative Transmetuese Jofitimprurëse RADIO UNIVERSITARE FM. 92.9, nr.23-1317/2 datë 24.12.2024 (nr.ynë ark.08-5275/1 datë 25.12.2024) deklaratën numër UZP 28/2025 datë 09.01.2025 (nr.ynë ark.08-62/2 datë 14.01.2025) nga personi i autorizuar – rektori i Universitetit “SHN. KIRILI DHE METODI” në Shkup dhe Konkluzionin ark.nr. 02-245/4 datë 22.01.2025, u miratua aktvendim si në dispozitiv, i cili hyn në fuqi menjëherë.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.